

“I don me i vu n’ hapsanë!” “Jo”, ju përgjigja: “ay don me fol me ta për me na giet një vënt se jena jabanxhi”. Passi u sigurua, vajza e mjerrë më flet me gjith zemër: “Mirse u pru Zoti!” U kënaq fort kur i thashë të vijë e të takohet me zonjën t’ onë e cila ish kaqe zemër-mirë.

Ju bërtita Amerikanëve dhe qiraxhinjvet që të vinin në kulla sepse e zonj’e shtëpisë kish kënaqësinë të na pranojë në shtëpin’ e saj. Erdhi karvani, edhe një plakë nonja shtraiçdhjet vjeç na zuri për dore dyke na thënë: “Oshxhell-dën!” Pastaj na shpuri ke oda e prijes ku kishin ndezur një zjar të math. Plaka ndenjl në mjërin kënt, dhe në të dytin vuri zonjën t’ onë. Pas kësaj filloj seremonia e përshëndoshjes: “Qysh je? a je, si je? a je loth? etj”.

Ndonëse plaka ish e shkuar nga mosha, prapë kish energjin’ e një të riu. Që nga këndi jepte urdhëra nuseve të ra, të cilat ja dëgjonin fjalën me një herë. Një djalë të vetëm që kish ja kishin vrarë gabimisht në kohën e sundimit Austriak dhe tani plaka e ngratë kish barrën e shtëpisë si një burrë. Shtëpia ka qënë sado e pasur; ka patur një livath të mirkë rreth e përqark edhe ca tokë për të mbjellë. Në shtëpi kish edhe një nip, po plaka thosh se nuk ish si fëmija e barkut.

U shtruam mirë mirë dhe pastaj ja nismë